



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV  
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 478 prot

Tiranë, më 30.07 2024

VENDIM

Nr. 6 datë 30.07 2024

PËR  
MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E  
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE  
VENDORE TË DATËS 29/7/2024

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe në VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, të mbledhjes së datës 29.7.2024 vendosi:

1. Për projektvendimin “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 328, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, propozuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Të njëhsohen lidhja 5 me lidhjen 6, pra nivelet e pagave për nëpunësit civil në bashkitë 50 000 -100 000 banorë me nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë me deri në 50 000 banorë.
2. Për projektvendimin **“Për miratimin e karakteristikave teknike të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla”** propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.
  3. Për projektvendimin **“Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet”** propozuar nga Ministra e Brendshme, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Në pikën 2 të PVKM të bëhen ndryshimet si më poshtë:

- Gërma a) të ndryshohet me përmbajtjen si vijon: “a) Përfaqësues i nivelit të lartë nga Drejtoria Vendore e Policisë/shefi i komisariatit sipas rastit”;
- Gërma d) të ndryshohet me përmbajtjen si vijon: “d) Drejtues i emergjencave civile në bashki”;
- Gërma j), l), o) p), q), r), të hiqen sepse e bëjnë jo realiste funksionimin e KVSP me një pjesëmarrje kaq të madhe. Për më tepër që kryetari i bashkisë mund të ftojë këto institucione në funksion të tematikës së mbledhjeve sipas sugjerimit që kam bërë në pikën 2.

Në pikën 4 të bëhen ndryshimet si më poshtë:

- Gërma e) të plotësohet me përmbajtjen si vijon: “e) Organizata të shoqërisë civile (organizata rinore, organizata të grave, biznese, shoqata të pakicave kombëtare, universitete, media vendore)”;
- Pas gërmës e) të shtohet gërma f) dhe g) me përmbajtjen si vijon: “f) Përfaqësues i Këshillit Vendor Rinor në bashki”. dhe “g) Sipas rastit çdo institucion publik në nivel rendor që lidhet me fokusin e rendit të ditës në mbledhje”.

Në pikën 5 të PVKM, pas gërmës h) të shtohet gërma i) me këtë përmbajtje: “ i) Zhvillon forumeve të hapura konsultative me qytetarët me qëllim identifikimin dhe evidentimin e problematikave lidhur me sigurinë në komunitet”.

Në pikën 6 të PVKM të bëhen këto ndryshime:

- Pas gërmës a) të shtohet gërma a/1 me përmbajtjen si vijon: “a/1 Harton dhe ve në zbatim, me dakordësi të anëtarëve, planin vjetor shumëaktorial vendor për parandalimin e risqeve të rendit dhe sigurisë në komunitet”.
- Gërma k) të ndryshohet me këtë përmbajtje si vijon: “k) Ngre Sekretariatit Teknik të KVSP. Ai përbëhet nga një punonjës i bashkisë dhe një punonjës i Komisarariatit Vendor të Policisë”.

**Z. Arbjan MAZNIKU**  
**Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor**  
**Bashkëkryetar**

**Z. Aldrin DALIPI**  
**Kryetar i Shoqatës së Këshillit**  
**të Qarqeve të Shqipërisë**  
**Bashkëkryetar**